



ISO = POLIFONIA

SHKURT 2006, NR. 2

Botimi i Këshillit të Muzikës Shqiptare dhe Seksionit Shqiptar të CIOFF-it
Realizuar në bashkëpunim me stafin e gazetës "Dita JUG"

Shqipëria ratifikon "biblën" e trashëgimisë kulturore shpirtërore

Nga Prof.Dr.
Vasil S.TOLE

Me kandidimin e iso polifonisë popullore shqiptare si "Kryevepër e trashëgimisë gojore dhe shpirtërore të njerëzimit", mbrojtur nga UNESCO, duket se një vëmendje gjithmonë dhe me e madhe po i kushtohet trashëgimisë shpirtërore të popullit shqiptar. Ndër të tjera edhe shteti shqiptar, institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore, si dhe personalitetet e fushës, u shprehën të gatshëm për njohjen, përhapjen dhe ratifikimin e të gjitha atyre dokumenteve ndërkombëtare që ruajnë dhe mbrojnë në mënyrë të veçantë trashëgiminë kulturore shpirtërore. Ky fakt u konkretizua ditën e hënë datë 13 mars me ratifikimin e projekt ligjit për Konventën e UNESCO-s propozuar nga Ministria e Turizimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Me 74 vota pro, parlamenti shqiptar ka ratifikuar konventën duke u rreshtuar përkrah shteteve të tjera të botës në ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale. Shtetit shqiptar qysh prej viti 1956, ka ratifikuar dhe pranuar konventat më të rëndësishme ndërkombëtare të cilat shtrijnë veprimtarinë e tyre në fushën e trashëgimisë kulturore. Kjo gjë është legjitimuar në ligjin 9048, dt. 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore".

e saj më të re: "Për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale". Qëllimi madhor i kësaj Konvente është ruajtja e trashëgimisë kulturore jomateriale; respektimi i trashëgimisë kulturore jomateriale të bashkësive, të grupeve dhe të individëve të prekur; sensibilizimi në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe të vlerësimit të saj të ndërsjellë; bashkëpunimi dhe asistencë ndërkombëtare.

Kjo Konventë, një ndër më të rëndësishmet e UNESCO-s për 10 vitet e fundit përfshin në vetvete dhe i referohet instrumenteve ndërkombëtarë ekzistues lidhur me të drejtat e njeriut, në veçanti si deklarates së përbotshme për të drejtat e njeriut të 1948-ës, paktit ndërkombëtar

vijon në faqen 2



Në foto: Grupi i polifonisë toske të fëmijëve të Qarkut Fier, në FFK Gjirokastra 2004.

Foto "Dita JUG"



Eno Koço shkruan për Neço Mukën

Kontributi muzikor i Neço Mukos shquhet në dy drejtime: për krijimin apo përshatjen e këngëve të lehta të mbështetura në traditat ndërkombëtare (së shumti greke dhe franceze) dhe për lëvizimin e stilizimin e këngës popullore polifo-nike himarjote brenda kuadrit tradicional, duke i dhënë kësaj kënge

një pamje të dallueshme e të veçantë. Ndër burimet muzikore mbi N. Mukon dhe këngën e lëvruar prej tij, janë regjistrime të këngëve folklorike poli-fonike (tri dhe katër zërshe) të kënduara nga Neçoja dhe tre këngëtarë të tjerë himariotë, Koço Çakalli, Andrea Bala dhe Pano Kokëveshi, të bëra në Paris në

vitet 1929-30. Po të kësaj periudhe e të njëjtit koleksion diskografik janë regjistrimet e Tefta Tashkos, Tulla Paleologut e Kleo Georgas, me ose pa grupin himarjot të udhëhequr nga N. Muko. Ndërsa repertori i këngëve folklorike himarjote dhe kultivimi që i bëri Neçoja atij është unikal në llojin...



Ministri Leskaj falënderon nismëtarët e rrjetit dhe gazetës "Iso-Polifonia"

Ministri i Turizimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Bujar Leskaj ka përshëndetur krijimin e rrjetit të Ios Polifonisë dhe gazetën "Iso Polifonia". Ai ka shprehur mbështetjen dhe përkrahjen e tij duke dërguar letra falenderimi për kryeredaktorin e gazetës Engjëll Serjani...

Rritur në brumin e gurit dhe polifonisë

Biznesmeni i fushës së ndërtimeve, gjirokastriti Shpëtim Emiri është sponsori i numrit të dytë të gazetës "Iso-Polifonia". Ai ka lindur në qytetin kryeqendër të polifonisë dhe njëkohësisht një qytet i përfshirë në listën e pasurive kulturore botërore. Fëmijëria e tij ka kaluar midis "mbretësisë" së gurtë, midis mureve, çatave dhe sokakëve ku



Në foto: Shpëtim Emiri.

guri është "gatuar" si brumi i bukës së ardhur në magje. Ashtu si guri edhe polifonia kanë qënë pjesë

e pandarë e jetës qytetare gjirokastrite. Shpëtim Emiri është i biri i një prej personazheve më të njohur të këtij qyteti, librarit që nuk pranonte të shiste asnjë titull libri nëse nuk e kishte lexuar më parë vetë, të pashuarit për gjirokastritët Alizot Emirit. Ndonëse Shpëtim Emiri pas përfundimit të studimeve universitare ka punuar larg Gjirokastrës, jehona e

këngëve polifonike që ai i vlerëson dhe adhuron e kanë shoqëruar gjatë gjithë jetës së tij. Stafi i gazetës "Iso-Polifonia" falenderon zotin Shpëtim Emiri për gadishmërinë e tij për të sponsorizuar numrin e dytë të saj dhe fton të gjithë adhuruesit e traditës muzikore të polifonisë që të japin kontributin e tyre në ruajtjen dhe zhvillimin e saj.

Historiku i Konventës:

Në sesionin e 32-të të saj, Konferenca e përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për arsimin shkencën dhe kulturën, UNESCO vendosi që të bëjë publike konventen

STAFI I GAZETËS
ISO-POLIFONIA

"Iso polifonia-Albanian Folk Iso Polyphony"

"Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit"

"A Masterpiece of oral and intangible heritage of humanity"

Organ i përmuajshëm i Këshillit të Muzikës Shqiptare, anëtar i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës IMC/UNESCO dhe seksionit Shqiptar të CIOFF-it. Gazeta botohet në qytetin muze të Gjirokastrës, "Pasuri kulturore e njerëzimit" mbrojtur nga UNESCO.

KËSHILLI BOTUES

KRYETAR NDERI: Prof. Ramadan Sokoll
KRYETAR I KËSHILLIT BOTUES:

Prof. Dr. Vasil S. TOLE.

ANTARË:

Akademik Jorgo Bulo, Prof. Dr. Fatmir Hysli,
Prof. Agron Xhagolli, Prof. Spiro Shituni (USA),
Dr. Eno Koço (Angli), Prof. As. Josif Minga,
Bardhyl Londo, Aleks Todhe.

DREJTOR: Niko Mihal.

KRYEREDAKTOR: Engjëll Serjani.

KOLEGJIUMI I REDAKSISË:

Arian Avrazi, Ilir Dhuri, Lefter Cipa, Muhamet Tartari, Sejmen Gjokoll, Maksi Kulo, Thanas Dino, Shkëlqim Hajno, Shkëlqim Guçe.
Pregatiti materialet në anglisht: Gentiana Brahim.

Art-Design: Klidi Proko.

Kontakt: Këshilli i Muzikës Shqiptare

e-mail: tole@isopolifonia.com

Mob: 0 68 21 55551

Seksioni shqiptar i Cioff-it:

E-mail: egjikassoc@albmail.com

Cel: 0 69 22 34986

Gazeta "Iso polifonia-Albanian Folk Iso Polyphony":

E-mail: ditajug@yahoo.com

Cel: 068 22 04502



Këshilli i Muzikës Shqiptare-KMSH është person juridik i regjistruar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë me nr. Akti 3074, me vendimin nr. 1784. K.M.SH-Albanian Music Council zyrtarisht njihet si Komiteti Nacional i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës (IMC)-UNESCO, në Shqipëri. (CIM/49.631).

Ratifikohet Konventa e UNESCO-s për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale



Nga Prof. Dr. Vasil S. TOLE

vijon nga faqja 1

mbëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të 1966-ës apo dhe paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike të 1966-ës.

Konventa duke marrë parasysh rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale, përmblendhëse e diversitetit kulturor dhe garanci e zhvillimit afatgjatë (siç theksohet në Rekomandimin e UNESCO-s për mbrojtjen e kulturës tradicionale dhe popullore të 1989-s, në Deklaratën e përbashkët të UNESCO-s për diversitetin kulturor të vitit 2001 dhe në Deklaratën e Stambollit të vitit 2002), duke marrë parasysh ndërvlerësinë midis trashëgimisë kulturore jomateriale dhe trashëgimisë materiale kulturore dhe natyrore; pranon se proceset e mondializimit dhe të ndryshimit shoqëror, krahas kushteve që krijojnë për një dialog të përtërirë mes bashkësive, shkaktojnë gjithashtu, njësoj si dhe dukuritë e mostolerancës, kërcënime të rënda për degradim, për zhdukje dhe shkatërrim të trashëgimisë kulturore jomateriale, veçanërisht për faktin e mungesës së mjeteve për ruajtjen e kësaj të fundit.

Konventa gjithashtu, vlerëson vullnetin e përbashkët dhe shqetësimin e përbashkët për të ruajtur trashëgiminë kulturore jomateriale të njerëzimit; duke pranuar se bashkësitë, në veçanti bashkësitë rrënjëse, grupet dhe, sipas rastit, individët, luajnë një rol të rëndësishëm në prodhimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe rikrijimin e trashëgimisë kulturore jomateriale, çka ndihmon kështu për pasurimin e diversitetit kulturor dhe të krijimtarisë njerëzore.

Në mënyrë të veçantë duke shënuar gjithashtu se deri më tani nuk ka asnjë instrument shumëpalësh me karakter shtrëngues që të synojë ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale; duke patur parasysh se marrëveshjet, rekomandimet dhe rezolu-



Në foto: Filantropi japonez Handa, një admirues i Iso-Polifonisë, mes grupit polifonik "Gurra e Picarit", në kalanë e Gjirokastrës. Foto "Dita JUG", datë 27/05/2002

tat ndërkombëtare që ekzistojnë lidhur me trashëgiminë kulturore dhe natyrore do të duhej të pasuroheshin dhe të plotësoheshin në mënyrë të frytshme me anë të dispozitave të reja lidhur me trashëgiminë kulturore jomateriale; duke patur parasysh detyrimin e bashkësisë ndërkombëtare për të dhënë ndihmesën me shtetet palë në këtë Konventë për ruajtjen e kësaj trashëgimie në një frymë bashkëpunimi dhe ndihme të ndërsjellë; duke patur parasysh programet e UNESCO-s lidhur me trashëgiminë kulturore jomateriale, duke patur parasysh rolin e paçmueshëm të trashëgiminë kulturore jomateriale si faktor afrimi, shkëmbimesh dhe kuptimi midis qenieve njerëzore u miratua Konventa në fjalë si në dokumentin përbashkët në funksion të trashëgimisë shpirtërore.

Përkufizimet e Konventës:

Në Konventë jepet edhe përkufizimi se çfarë kuptojmë me trashëgimi shpirtërore, duke theksuar se ky togfjaësh kupton më së pari të gjitha praktikatat, paraqitjet, shprehjet, njohuritë dhe dijeberja si dhe veglat, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore që bashkëshoqërojnë ato – që bashkësitë, grupet dhe, kur është rasti, individët i pranojnë si pjesë përbërëse të trashëgimisë së tyre kulturore. Konventa, duke ju referuar procesit të krijimit të kësaj trashëgimie, vlerëson me respekt se kjo trashëgimi e përcjellë brez pas brezi, është rikrijuar në vijimësi nga bashkësitë dhe grupet në funksion të mjedisit të

tyre, të ndërveprimit të tyre me natyrën dhe të historisë së tyre, dhe u jep atyre një ndjenjë identiteti dhe vazhdimësie, duke ndihmesuar kështu për promovimin e respektit për diversitetin kulturor dhe të krijimtarisë njerëzore.

Ç'ka është shumë e rëndësishme, Konventa përcakton saktësisht edhe fushat të cilat trashëgimia shpirtërore përfshin si: traditat dhe shprehjet gojore, përfshirë këtu edhe gjuha si vektor i trashëgimisë kulturore jomateriale; artet e shfaqjes (spektaklit); praktikatat sociale, ritualet dhe ngjarjet festive; njohjet dhe praktikatat lidhur me natyrën dhe gjithësinë; dijeberja lidhur me artizanatin tradicional. Duke shpjeguar saktësisht se qëllimi i saj kryesor është ruajtja e kësaj trashëgimie, në të shpjegohet se ruajtja e trashëgimisë shpirtërore së pari kupton të gjitha ato masa që synojnë jetëgjatësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale, përfshirë këtu identifikimin, dokumentimin, kërkimin, ruajtjen, mbrojtjen, promovimin, vlerësimin, përcjelljen, kryesisht përmes edukimit formal dhe joformal, si dhe rigjallërimi i aspekteve të ndryshme të kësaj trashëgimie.

Angazhimet ndërkombëtare:

Një vend i veçantë në Konventë i kushtohet ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale në shkallë ndërkombëtare. Për këtë, Konventa rekomandon që të punohet për një ndërgjegjësim më të mirë të rëndësisë së saj dhe për të favori-

zuar dialogun duke respektuar diversitetin kulturor. Komiteti, me propozim të shteteve palë të interesuara harton, përditëson dhe publikon një listë paraqitëse të trashëgimisë kulturore jomateriale të njerëzimit. Komiteti harton dhe i paraqit për miratim Asamblesë së përgjithshme kriteret kryesore për hartimin, përditësimin dhe publikimin e kësaj liste paraqitëse.

Në bazë të propozimeve të paraqitura nga shtetet palë, dhe në përputhje me kriteret që ai përcakton dhe që janë miratuar nga Asambleja e përgjithshme, Komiteti për detyrë që të përzgjedhë periodikisht dhe të promovojë programe, projekte dhe veprimtari me karakter kombëtar, nënrajonale ose rajonale për ruajtjen e trashëgimisë që ai i gjykon se pasqyrojnë më mirë parimet dhe objektivat e kësaj Konvente, duke mbajtur parasysh nevojat e veçanta të vendeve në zhvillim. Për këtë qëllim ai merr, shqyrton dhe miraton kërkesat për mbështetje ndërkombëtare të formuluara nga shtetet palë për hartimin e këtyre propozimeve. Komiteti e shoqëron zbatimin e këtyre programeve, projekteve dhe veprimtarive me përhapjen e praktikave më të mira sipas modaliteteve të paracaktuara prej tij.

Ratifikimi së fundi nga ana e Kuvendit të Shqipërisë i kësaj Konvente (Këshilli i Ministrave e ka aprovuar në vitin 2005), do të sjellë një status më shumë mbrojtjeje, ruajtje dhe popullarizimi ndërkombëtar të trashëgimisë shpirtërore shqiptare, të bartësve dhe studiuesve të saj.

Një gazetë dhe një rrjet për Iso-polifoninë



Promovohet gazeta "Iso-Polifonia" dhe formohet në Përmet rrjeti i parë i shoqatave të Isopolifonisë

Seksioni Shqiptar i CIOFF dhe Këshilli i Muzikës Shqiptare ka zhvilluar në javën e fundit të shkurtit në qytetin e Përmetit, njerin nga qytetet bartës autentik të isopolifonisë një tubim promovues për gazetën e re "Iso-Polifonia" dhe për themelimin e rrjetit të parë të shoqatave të isopolifonisë.

Në fillim të këtij takimi, kryetari i Seksionit Shqiptar të CIOFF-it, drejtori i gazetës "Iso-Polifonia" dhe njëkohësisht inisiatori i krijimit të rrjetit të Isopolifonisë zoti Niko Mihali falenderoi pjesëmarrësit në këtë veprimtari promovuese të artistëve nga grupet polifonike të Sarandës, Gjirokastrës, Vlorës, Mallakastrës, Tepelenës, autoritetet e pushtetit vendor, kryetarin e këshillit të qarkut të Gjirokastrës Resul Llogo dhe kryetarin e bashkisë së qytetit Petrit Bregasi, nënprefektin Pëllumb Pacani, përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve, përkatësisht Prof. Dr. Vasil Tole, drejtor i Trashëgimisë Kulturore dhe inspektorin e kësaj drejtorie Arjan Avrazi.

Gjatë fjalës së tij, zoti Niko Mihali u shpreh "gjej rastin të përshëndes të gjithë faktorët e përkushtuar ndaj isopolifonisë për gadishmërinë e tyre për të ardhur këtu në Përmet dhe për të diskutuar së bashku rreth përgjegjësisë të reja që lidhen me Udhëzimin e ministrit të Turizmit Kulturës e Rinisë dhe Sporteve z Bujar Leskaj të nxjerrë disa ditë pas shpalljes së Isopolifonisë shqiptare si Kryevepër e Trashëgimisë orale të njerëzimit. Ju vini këtu nga qytete e vendbanime që nga Saranda deri në Elbasan ku është kufiri ndarës i kësaj vlere për të dhënë një kontribut të ri në zhvillimin e pasurimisë e mëtejshme dhe për të forcuar bashkëpunimin tonë lokal, kombëtar edhe ndërkombëtar në interes të isopolifonisë", u shpreh zoti Mihali.

Duke marrë fjalën në këtë takim të gjerë promovues, zoti Vasil Tole tha se: "Ju që sot jeni mbledhur këtu në Përmet, kemi qenë ndër aktorët kryesorë të lëvrimin të isopolifonisë, keni qenë dhe jeni pjestarë të grupeve polifonike, jeni ata që jo vetëm e keni ruajtur këtë traditë të vyer, por na keni dhuruar kënaqësi dhe emocione të përhershme, por që ju ndjemë më afër atë ditë nëntori kur Këshilli i Unesco-s me shumicë votash vendosi të pranojë si vlerë Isopolifoninë".

Lidhur me botimin dhe shpërndarjen e numrit të parë të gazetës "Iso-Polifonia", drejtori i gazetës "Dita jug" dhe njëko-



Në këtë takim u firmos dokumenti për themelimin e rrjetit të shoqatave të isopolifonisë dhe në një relacion informues drejtuar ministrit të T.K.R.S.

Pamje nga veprimtaria për promovimin e gazetës dhe krijimit të rrjetit "Iso Polifonia", Përmet 22.02.2006.

Foto "Dita JUG"

Leskaj: Rrjeti shtysë për promovimin e iso-polifonisë

Ministri i TKRS, Leskaj përshëndet gazetën "Iso Polifonia" dhe krijimin e rrjetit të Iso Polifonisë

Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Bujar Leskaj ka përshëndetur krijimin e rrjetit të Iso Polifonisë dhe gazetën "Iso Polifonia". Ai ka shprehur mbështetjen dhe përkrahjen e tij duke dërguar letra falenderimi për kryeredaktorin e gazetës Engjëll Serjani dhe kryetarin e seksionit të CIOFF-it Niko Mihali. Letrën drejtuar zotit Mihali thuhet "në emër të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe

Sporteve dhe timin personal, ju shpreh zyrarisht konsideratën dhe falenderimet institucionale për punën e Seksionit Shqiptar të CIOFF-it në krijimin e Rrjetit të Shoqatave të Iso-Polifonisë. Jam i bindur se krijimi i këtij rrjeti do të ndihmojë në ruajtjen, studimin, promovimin dhe popullarizimin mbarëkombëtar e ndërkombëtar të iso-polifonisë si vlerë e pamohueshme e trashëgimisë shpirtërore sh-

qiptare, që tashmë është pjesë e "Kryeveprave të trashëgimisë gojore të njerëzimit", të mbrojtur nga UNESCO".

Më tej në letër thuhet se "mendoj se kjo punë e nisur do të zgjerohet me veprimtari të ndryshme multikulturore të trashëgimisë shpirtërore shqiptare në të mirë të ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të saj në përgjithësi dhe të Iso-polifonisë në veçanti, duke shër-

byer në gjallërimin e jetës kulturore të vendit dhe të zhvillimit të veprimtarive në kuadrin e turizmit kulturor". "Duke ju falenderuar edhe njëherë, ju theksoj se trashëgimia kulturore e në mënyrë të veçantë trashëgimia shpirtërore dhe folklori ynë i mrekullueshëm do të jenë një prioritet afatgjatë i punës së Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve", përfundon letrën e tij ministri Bujar Leskaj.

Urim për kryeredaktorin e "Iso Polifonisë"

Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Bujar Leskaj ka përshëndetur krijimin e rrjetit të Iso Polifonisë dhe gazetën "Iso Polifonia". Ai ka shprehur mbështetjen dhe përkrahjen e tij duke dërguar letra falenderimi për kryeredaktorin e gazetës Engjëll Serjani dhe kryetarin e seksionit të CIOFF-it Niko Mihali. Letrën drejtuar zotit mihali thuhet "në emër të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe timin personal, ju shpreh zyrarisht

konsideratën dhe falenderimet institucionale për punën e Seksionit Shqiptar të CIOFF-it në krijimin e Rrjetit të Shoqatave të Iso-Polifonisë. Jam i bindur se krijimi i këtij rrjeti do të ndihmojë në ruajtjen, studimin, promovimin dhe popullarizimin mbarëkombëtar e ndërkombëtar të iso-polifonisë si vlerë e pamohueshme e trashëgimisë shpirtërore shqiptare, që tashmë është pjesë e "Kryeveprave të trashëgimisë gojore të njerëzimit", të mbrojtur nga UNESCO". Më tej në letër thu-

het se "mendoj se kjo punë e nisur do të zgjerohet me veprimtari të ndryshme multikulturore të trashëgimisë shpirtërore shqiptare në të mirë të ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të saj në përgjithësi dhe të Iso-polifonisë në veçanti, duke shërbyer në gjallërimin e jetës kulturore të vendit dhe të zhvillimit të veprimtarive në kuadrin e turizmit kulturor". "Duke ju falenderuar edhe njëherë, ju theksoj se trashëgimia kulturore e në mënyrë të veçantë trashëgim-

ia shpirtërore dhe folklori ynë i mrekullueshëm do të jenë një prioritet afatgjatë i punës së Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Kujdesi ynë për trashëgiminë kulturore shpirtërore dhe turizmin kulturor do të ndikojë në mënyrë të veçantë në rritjen e cilësisë dhe financimeve për këto veprimtari, të cilat do të sjellin një vëmendje mbarëkombëtare për këto vlera të krijuara nga populli ynë", përfundon letrën e tij ministri Bujar Leskaj.

hësisht edhe kryeredaktor i gazetës së re "Iso-Polifonia", gjatë fjalës së tij u përqëndrua në misionin fisnik të këtij botimi special dhe në domosdoshmërinë e një bashkëpunimi të ngushtë mes këshillit botues, redaksisë, institucioneve kërkimore, studimore e shkencore me rrjetin e shoqatave të isopolifonisë për të zbuluar vlerat e vërteta të kësaj pasurie të rrallë.

Në këtë takim shprehën mendimet dhe idetë e tyre edhe drejtori i Qendrës Kombëtare të In-

ventarizimit të Pasurive Kulturore Koço Gjipali, inspektori i trashëgimisë kulturore në MTKRS Arjan Avrazi, shkrihtarët dhe gazetarët, Thanas Dino, Odise Kote, Bardhul Bejko, Luan Sejdiu e Thoma Nika, artistët bartës të polifonisë Timo Mërkuri, Bajo Koli e Guri Rrokaj, etj.

Ata vlerësuan iniciativën e botimit të gazetës dhe përpjekjet për krijimin e rrjetit të shoqatave të konceptuar si mjete të përfitimit nga përvojat e njeri tjetrit dhe si struktura që promo-

vojnë veprimtaritë e polifonisë, që demonstrimë frymën e dashurisë, mirëkuptimit, tolerancës e diversitetit kulturor dhe si vlera të mirëfillta integrimi në Evropën e bashkuar.

Pjesëmarrësit në këtë takim firmosën dokumentin për themelimin e rrjetit të shoqatave të isopolifonisë dhe në një relacion informues drejtuar ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, zotit Bujar Leskaj. Me anë të këtij relacioni, ministri Leskaj informohet se rrjeti i sho-

qatave, institucioneve e grupeve folklorike që promovojnë isopolifoninë do të fokusohet dhe angazhohet në ruajtjen dhe zhvillimin e kësaj vlere duke e shtrirë në çdo moshe e zonë etnografike duke zgjeruar pjesëmarrjen në veprimtari lokale, kombëtare e ndërkombëtare isopolifonisë dhe se veprimtari e këtij rrjeti do të gjejë pasqyrim të përhershëm në faqet e gazetës "Iso-Polifonia"

Gentiana Brahimi
Përmet, 22 shkurt 2006

Neço Muko legjenda e këngës himariote

Disa fjalë për Neço Mukon, këngën dhe mikun e tij Janko Palin si dhe nënën time, Teftën

Nga Dr. As. Prof.
Eno Koço *

Kontributi muzikor i Neço Mukos shquhet në dy drejtime: për krijimin apo përshtatjen e këngëve të lehta të mbështetura në traditat ndërkombe (së shumti greke dhe franceze) dhe për lëvrimin e stilizimin e këngës popullore polifonike himarjote brenda kuadrin tradicional, duke i dhënë kësaj kënge një pamje të dallueshme e të veçantë. Ndër burimet muzikore mbi N. Mukon dhe këngën e lëvruar prej tij, janë regjistrime të këngëve folklorike polifonike (tri dhe katër zërshë) të kënduara nga Neçoja dhe tre këngëtarë të tjerë himariotë, Koço Çakalli, Andrea Bala dhe Pano Kokëveshi, të bëra në Paris në vitet 1929-30. Po të kësaj periudhe e të njëjtit koleksion diskografik janë regjistrimet e Tefta Tashkos, Tulla Paleologut e Kleo Georgas, me ose pa grupin himarjot të udhëhequr nga N. Muko. Ndërsa repertori i këngëve folklorike himarjote dhe kultivimi që i bëri Neçoja atij është unikal në llojin e vet, repertori i muzikës së lehtë i përshtatur përsëri nga Neçoja në regjistrimin e këngëtarëve të mësipërm, të shoqëruara me piano dhe një violi, ka mjaft tipare të përbashkëta me këngët/serenata korçare. Shembull kup-timplotë i kësaj pike takimi mund të jetë kënga "Korçarja e bukur."

U ballafaqova me këto regjistrime për herë të parë në Himarë në saj të Spiro Çakallit, por mjaft më të plotë, bashkë me Spiron, morëm informacion mbi Neçon dhe bëmat e tij në shtëpinë e Janko Palit, në Qeparo lart, Himarë, në fillim të viteve 1980. Janko Pali, që në vitet 1920-30 kishte qenë mik i ngushtë me Neçon, për disa dekada në vitet e pasluftës bëri detyrën e mësuesit në Qeparo e përreth. Informacionin që mora prej tij, i bazuar ky mbi një material të pasur faktik e hulumtues, i ruajtur e sistemuar sipas kodeve e normave arkivale, e për më tepër i shoqëruar me episode jetësore të rrëfyera drejtpërdrejt nga goja e tij, do



NË FOTO:

Dr. As. Prof. Eno Koço dhe Kryetari i Bashkisë Përmet, Petrit Bregasi, gjatë përrimit të bustit Tefta Tashko Koço në ditët e festivalit Përmetit Multikulturor 2004.
Foto "Dita JUG"

Urim nga Londra për gazetën "Iso Polifonia"

Të dashur inisiatorë të gazetës "Iso Polifonia"! Ju uroj nga zemra për këtë nismë të bukur e shumë me vlerë. Jam i bindur që do të jetë një tribunë e hapur diskutimi ku veç pasqyrimin të veprimtarive të kësaj fushe do të hidhen edhe gjykime të reja mbi sekretet e këngës shumëzërshë e të mrekullueshme të jugut. Është një lëmë që ka shumë interes edhe nga të huajt e prandaj përcimi i shkrimeve studimore të kësaj gazete tek qendrat etnomuzikologjike botërore do të ishte një kontribut i madh për këtë këngë kaq të veçantë e vlerësuar së fundi edhe nga UNESCO. Rrugë të mbarë e jetëgjatësi.

Dr. As. Prof. Eno Koço

të plotësonte më së miri atë kuadër aq të nevojshëm mbi vërtetësinë e të dhënave mbi Neçon.

Në një nga këto biseda në shtëpinë e tij, më 11 gusht 1982, barba Janko më rrëfen: "Neçon e kam njohur në vitin 1925. U bëmë shokë të ngushtë. Në 1927 u ktheva përfundimisht nga Franca. Edhe Neçoja kishte qenë në Francë në periudhën kur isha unë. Shkollën e mesme e bëri në Greqi. Punoi si mekanik nëpër anije të ndryshme dhe i takoi të udhëtonte gjatë. U sëmur dhe u kthye në Sarandë. Atje filloi të merrej me muzikë." Më pas, barba Jankoja nxori nga sepeta e dhomës së bukës nota muzikore të disa këngëve greke e franceze dhe shtoi që "këto i ka kopjuar vetë Neçoja me bojë shkrimi, thjesht për kënaqësinë e tij për t'i ekzekutuar me mandolinë." Këngët ishin të përmbledhura në një album të lidhur me shumë kujdes nga vetë Neçoja. Midis tyre lexoja (në fakt m'i përthente Barba Jankoja sepse titujt ishin në greqisht dhe unë nuk kuptoja): "Nën tingujt e kitarës" – kënga e vjersha

N. Muko; "Në valët e Jonit" – kënga e vjersha N. Muko; "Kurbeti" – kënga e vjersha N. Muko, "Vajza e stuhisë" – muzika Saqel-lariu, e shqipëruar nga N. Muko. Ndërsa kënga "Shpresat dhe ëndërat" ishte përkthyer fjalë për fjalë nga greqishtja. Pashë edhe të tjera këngë. Kaligrafia e notizimit ishte me të vërtetë e bukur ndonëse kishte gabime vlerash të notave. Mes notizimeve kishte dhe mjaft syresh që mendoj nuk duhet të ishin të shkruara nga Neçoja, pasi shihej ndryshimi i notëshkrimit. Albumin e shoqëronin dy disqe me këngët "Tirana" dhe "Saranda" të regjistruara në Paris. Barba Janko më ofroi t'i hedh një sy edhe radhorit të tij personal, ndërsa ç'i përkiste bllokut të shënimeve të Neços, "atë" – më tha, "ma dhuroi vetë ai më 1927." Ndërkaq, shprehu me pak sa zemërim faktin që shkrimin e tij për jetën e Neços ia kishte dhënë të nipit të këtij të fundit, Kiços, që jetonte në Tiranë dhe që kish dy muaj që kish vdekur, dhe që ai shkrim u botua në *Nëntori* nga Andrea Varfi ku emri i Janko Palit nuk për-

mendej si autor.

Pas një viti, d.m.th. më 30 korrik 1983, u ngjita përsëri në shtëpinë e Janko Palit në Qeparo lart. Këtë radhë isha bashkë me Spiro Çakallin. Na shtroi një drekë shumë të shijshme të servitur me shumë kulturë, siç i thoshim ne atëherë, ku më ranë në sy jo vetëm takime të bukura e të shtrënjta, me dy disa lloj pjatash (për supë e për gjellë, për ëmbëlsirë dhe për fruta), lugë, pirunje e thika mbase argjendi, por edhe intervali dhe shërbesa nga e para tek e fundit bëhej me ritmin e tretjes së ushqimit. Më pas Janko Pali na shpjegoi: "Kënga *Shqipëria*," me të cilën hapej katalogu i këngëve të regjistruara në Paris më 1929-1930, kënduar nga Koço Çakalli dhe shoqëruar me piano e një violi, "është marrë nga Neçoja nga një libër me këngë franceze, dhe kjo këngë është notë për notë e ngjashme me këngën *Valencia*, qytet në Spanjë. Neçoja i vuri fjalët e tija mbi muzikën origjinale të autorëve Lucien Boyer (fjalët) dhe José Padilla (muzika)." Veç repertorit të regjis-

truar në 33 disqe në Paris, N. Muko shkroi edhe tri opereta (shfaqje te tipit të estradës) me titujt "Mar-rëzia e përgjithëshme" (1923), "Orsa-Forca" (1929) dhe "Zonja shërbëtore" (me një akt). Këngët që përfshiheshin në këto opereta/estrade dhe aq më tepër ato që përfshiu në grupin koral të shoqërisë "Miqte e dëfrimit," apo PIF-PAF, ishin krejt të tija dhe një pjesë e mirë nisën të këndohen në gjuhën shqipe (veç greqishtes). "Sarandita," për shembull, pavarësisht nga origjina e bazuar mbi një melodi të lehtë të huaj, mori karakterin e hovit e temperamentit shqiptar. Në këtë drejtim Neço Muko së toku me Thoma Nasin mund të konsiderohen si pionierët e këngës së lehtë shqipe, këngë e cila huazoi nga ajo e huaj tipare të veçanta, midis të tjerave, sentimentalizmin, për ta shndërruar këtë në dimensione shpirtërore vendase, d.m.th., duke i dhënë më tepër karakter shoqëror se sa individual.

Prirja kryesore e Neços në fushën e muzikës së lehtë ishte adaptimi, përshtatja, në mënyrë që kjo gjini të bëhej pronë e muzikdashësve të Bregut. Neçoja kishte veti natyrore ta riprodhonte një këngë të re me një të dëgjuar, të themi, në koncertin apo programin e radios së një nate më parë. E transkriptonte më pas atë dhe në ndonjë rast e përkthente në shqip. Prandaj, është e natyr-

shme që meloditë e tij shpesh të ngjanin me këtë apo atë melodi greke (si rasti i këngës "Sorkadhja e malit" ku motivi shëmbëllen grek pasi vargu i fundit përsëritet ashtu si në këngët greke), por edhe këto, në fund të fundit, ishin huazuar nga jashtë Greqisë. Dinamika që Neçoja i dha shfaqjeve tip-operete apo këngës tradicionale himarjote, gjë që vërehet qartë edhe nga regjistrimet në disqe, është një fenomen i mirëfilltë transformues, unik e krejt i veçantë, ku ai ka vulën e tij në historinë e muzikës shqiptare. Edhe pse kënga tradicionale polifonike himarjote dhe kontributi i Neços në të nuk ka të bëjë me këngën e lehtë, është pikërisht N. Muko ai që i mishëroi në qenien e tij të dy këto drejtime, mishëroi atë stil vetjak që i jepte rëndësi interpretimit të gjallë muzikor, improvizimit të çastit, trajtimit të muzikës si përvojë të gjallë jetësore. Prirja novatore e Neços u shqua në ndikimin që ai la në muzikën tradicionale të krahinës së tij, Himarës. Ai njihet nga vendasi, por dhe tërë Labëria, si pasuruesi i këngës shumëzërshë polifonike himarjote. Tipari krijues i tij ishte që këngës himarjote, t'i jepej më shumë lëvizje e zhdërvjelltësi, ëmbëlsi dhe muzikalitet. Pra, e bëri këngën himarjote të dallohej nga ajo labe gjirokastrite e vlonjate të cilat përçojnë lëvizje më të përmbajtura, tone më epike dhe impulse ritmike më të forta. Zërin e tretë, *hedhësin*, N. Muko e veçoi dhe e bëri funksional, duke e vendosur shpesh në marrëdhënie intervalore *terce*. Tipi i "ri" himarjot nisi të njihet, siç e përshkruan J. Bali, si "avaz himarjot" dhe u pasurua më tej edhe nëpërmjet përshtatjes e lëvrimin që Mukoja i bëri disave prej tyre nëpërmjet shoqërimin instrumental muzikor. I tillë ishte rasti i këngës "Lilaj Çobani."

* Senior Teaching Fellow in the School of Music University of Leeds, Leeds LS2 9JT, UK

vijon në numrin e ardhshëm

Nga Engjëll Serjani

Grupi polifonik i Picarit në Gjirokastrë ka festuar të premten më 10 mars përvjetorin e 15-të të themelimit të të parës shoqërisë kulturore folklorike të fokusuar tek ruajtja dhe zhvillimi i isopolifonisë, shoqatës së pagëzuar "Gurra e Picarit".

Shoqata Kulturore - Artistike - Folklorike "Gurra e Picarit" është regjistruar nga Ministria e Drejtësisë në listën e shoqatave kulturore qysh më 10 mars të vitit 1991 dhe prej asaj kohe ajo ka zhvilluar një veprimtari të dendur kombëtare dhe ndërkombëtare në lëvizimin e folklorit të pasur në gjuhën e polifonisë labe që përfshin dhe karakterizon zonën e Picarit.

Në veprimtarinë përkujtimore të zhvilluar në lokal "Gurra" në qendër të fshatit Picar, morën pjesë përfaqësues të të gjithë brezave të bartësve të folklorit të këtij grupi të njohur në shkallë vendi, përfaqësues të pushtetit vendor dhe të insitucioneve kulturore në Gjirokastrë, përfaqësues të mediave lokale dhe qëndrore, drejtori i firmës ndërtuese të autostradës Gjirokastrë - Tepelenë Vasili Polena dhe të ftuar të tjerë.

Kryetari i komunës së Picarit, themelues dhe drejtor artistik i shoqatës "Gurra e Picarit" dhe



Në foto: Grupi i polifonik "Gurra e Picarit".

Kosovë. Grupi folklorik i shoqatës "Gurra e Picarit" është pjesëmarrës i 7 festivaleve folklorike kombëtare të zhvilluara në skenën e Kalasë së Gjirokastrës dhe në disa prej tyre ka marrë vlerësime të larta për interpretime orgjinale dhe cilësore. Në përbërje të shoqërisë janë: grupi i këngës polifonike labe, grupi i valles së kënduar dhe grupi i instrumentave popullore ku përfshihen kryesisht instrumentat tradicional të kësaj zone etno-muzikore cylet dhe dyjaret.

Shoqata kulturore artistike "Gurra e Picarit" është aderuese në Qendrën Ndërkombëtare të Organizimit të Veprimtarive Folklorike C.I.O.F.F. dhe së fundi është pjestare e Rrjetit të Shoqatave të Iso-Polifonisë që u themelua në muajin shkurt 2006 në qytetin e Përmetit.

Sipas drejtuesit artistik të shoqërisë Shkëlqim Guçe, grupi i Picarit ka të arkivuara një numur të madh këngësh polifonike të regjistruara në studiot e Radio Gjirokastrës dhe të ruajtura në fonotekën e këtij institucioni, ka në qarkullim një album këngësh dhe ka regjistruar dhe e ka gati për ta hedhur në qarkullim albumin e tij të dytë muzikor të titulluar "Ku rri ndezur prushi i këngës".

Picari, aty ku rri ndezur prushi i polifonisë labe

Grupi polifonik i Picarit feston 15 vjetorin e themelimit të shoqërisë kulturore "Gurra e Picarit"

njëkohësisht edhe një nga artistët më të spikatur të këtij grupi, zoti Shkëlqim Guçe pasi falënderoi të pranishmit në këtë përvjetor, uroi artistët dhe folkloristët picariot për kontributin e tyre në këtë 15-vjetor. "Në radhë të parë do të falënderoja sponsor-

in e parë të grupit tonë, të ndjerin Ramo Guçe, njeriun që e dashuronte aq shumë polifoninë dhe që me të ardhurat e tij mundësoi themelimin e shoqërisë dhe veprimtaritë e para të saj, falënderoj të gjithë ata që u përfshinë në veprimtarinë

folklorike të kësaj shoqate, falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar sipas mundësive të tyre për të mbajtur gjallë folklorin tonë të bukur këtë dëshmi të identitetit tonë kulturor dhe etnik", tha zoti Shkëlqim Guçe në përfshendetjen e tij.

Grupi folklorik i kësaj shoqërie në 15 vjetë veprimtari numëron një numur të madh interpretimeve orgjinale të polifonisë, pjesëmarrje në dhjetra veprimtari lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare në Shqipëri, Itali, Francë, Greqi, Turqi,

FJALOR I ISO-POLIFONISË

ISO:

